

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Blerje karburant për automjete”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09100000-0, Karburante

VLERA E FONDIT LIMIT: **19 068 484.7** *(nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër pikë shtatë) Lekë pa Tvsh.*

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është **197 294.2** *(njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër pikë dy) Euro pa Tvsh.*

P.s Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë **28.01.2026** është **96.65** *(nëntëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë e pesë).*

LOTI I PARË

Objekti i prokurimit: **“Blerje gazoil”** shuma e sigurimit të ofertës është **339 984** *(treqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) Lekë.*

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është **3 517.6** *(tre mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë pikë gjashtë) Euro.*

P.s Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 28.01.2026 është 96.65 *(nëntëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë e pesë).*

LOTI I DYTË

Objekti i prokurimit: **“Blerje benzinë”** shuma e sigurimit të ofertës është **41 384.9** *(dyzet e një mijë e treqind e tetëdhjetë e katër pikë nëntë) Lekë.*

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është **428** *(katërqind e njëzet e tetë) Euro.*

P.s Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 28.01.2026 është 96.65 *(nëntëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë e pesë).*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia**

Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI I PARË; Blerje Gazoil me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën përkatëse për tregtimin e karburanteve, sipas objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; në zbatim të Ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për praktikimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit,

duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit. Kjo certifikatë ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Është pranuar në mbarë botën se burimet e botës sonë, që po pakësohen nga dita në ditë, nuk janë të pafundme dhe se ndikimet mjedisore të produkteve dhe aktiviteteve nuk janë lokale dhe rajonale por globale. Ky ndërgjegjësim ka sjellë nevojën për të kontrolluar ndikimet mjedisore. Përveç përmbushjes së pritshmërive dhe nevojave të konsumatorëve të sotëm në nivelin më të lartë, kërkohet që të vlerësohet dhe respektohet mjedisi dhe bota në të cilën jetojmë. Këto zhvillime kanë zbuluar faktin se ekziston një nevojë për sisteme menaxheriale që do t'u mundësojnë bizneseve të mbajnë nën kontroll ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të përmirësojnë vazhdimisht aktivitetet dhe arritjet e tyre mjedisore. ISO 14001 është një standard i sistemit, i cili bazohet në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore dhe është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe ligjet në lidhje me faktorët e mjedisit. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit quhet Sistemi i menaxhimit që çdo kompani zhvillon për reduktimin sistematik dhe eliminimin e mundshëm të dëmeve që ato mund të shkaktojnë në mjedis. Pra si rezultat i këtij gjykimi menaxhimi i mjedisit që ka lidhje me certifikatën ISO 14001:2015 është standart me të cilin duhet të operojë çdo kompani pavarësisht fushës së saj të aktivitetit apo madhësisë së saj. Ky standart tregon se kompania gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj operon në përputhje me parimet e mbrojtjes së ekosistemit dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis. Në rastin e kësaj procedure furnizimi dhe shpërndarja me karburant për ngrohje në objektet arsimore duhet patjetër të shoqërohet me garanci për mbrojtjen e mjedisit, pasi natyra dhe përdorimi i mallrave objekt prokurimi lidhet drejtpërdrejt me ndikimin në mjedis.

2.1.4 Organi vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji Nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji Nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr.667, datë 29.07.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që *bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).*

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; **a)** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, **b)** Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: *Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të*

treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë-analizë për produktin Gazoil lëshuar nga ente certifikuese të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë për produktin objekt prokurimi me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara. Dëshmia me rezultatet e testimeve zyrtare duhet të jetë lëshuar jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e zhvillimit të tenderit.

(Dokumentacioni për vërtetimin e akreditimit të entit certifikues të kërkuar më sipër do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.)

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligji nr.8450, datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të tyre, i ndryshuar”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me karburant për automjetet dhe pajisjet teknike të cilat duhet të funksionojnë sipas specifikimeve teknike të tyre, duhet të dëshmojnë që produkti ka minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në automjetet dhe pajisjet teknike në të cilat do të përdoret pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte automjetet ose pajisjet teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të posedojë minimumi 3 (tre) stacione të tregtimit me pakicë të karburantit në Territorin e Bashkisë Tiranë. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas vendodhjes të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie dhe të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB ose kontratë noteriale qeraje). Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhen të jenë të pajisur me Vërtetim Teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), për distributorët e shitjes me pakicë, i cili duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve ATP dhe kamionë të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për mirëmbajtjen e afro 300 objekteve shkollore dhe parashkollore të Bashkisë së Tiranës të cilat janë të shpërndara në të gjithë territorin e saj, prandaj numri i stacioneve të tregtimit me pakicë të karburanteve është mëse i nevojshëm për autoritetin kontraktor dhe konsiderohet thelbësor në përmbushjen e detyrave të tij funksionale. Kjo sasi e kërkuar për posedimin e pikave me pakicë të tregtimit të karburantit është gjykuar e nevojshme dhe nga eksperiencia e autoritetit kontraktor gjatë viteve të mëparshme ku është konstatuar e nevojshme mundësia e furnizimit të automjeteve në minimalisht 3 (tre) stacione tregtimi, pasi kjo do të sillte efikasitet në kursimin e karburantit, në kushtet kur automjetet e autoritetit kontraktor e kanë vendqendrimin e tyre në 3 (tre) vendodhje të ndryshme, në Vaqarr, në Rrugën Shkozë dhe Rrugën 5 Maji.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI (Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial), që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë së karburantit përgjatë Vitit 2024 dhe Vitit 2025.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c) dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Meqënëse kontrata e parashikuar ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh, Autoriteti Kontraktor me anë të këtij kriteri kërkon të sigurohet për furnizimin e produktit objekt prokurimi në vazhdimësi, me cilësinë e kërkuar në DST.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- ❖ Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 (njëzet e katër) orë me karta elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- ❖ Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- ❖ Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që në rast të nevojave teknike të autoritetit kontraktor *(nevojat për furnizim të motorrëve me gazoil stacionarë si, motopompa uji, motopompa dezinfektimi, motobetoniere etj.)* të konvertojë me tollona sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar, deri në përfundim të plotë të kontratës. Kartat elektronike duhet të jenë pa afat skadence deri në përfundimin e plotë të kontratës.

- ❖ Bazuar në VKM Nr.561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.
- ❖ Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi (shtimi dhe pakësimi) i sasisë së karburanteve, të kryhet nga vetë Autoriteti Kontraktor.
- ❖ Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë dhe shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike, stikera (pulla), të cilat ngjiten në xhanim e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet, për të eliminuar lëvizjen e mundshme të targave nga mjete shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të emailit për çdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj.
- ❖ Disponimi/ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin e shërbimeve të kërkuara më sipër, do të demonstron nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, me shembuj për zbatimin në praktikë, në prani të anëtarëve të KVO-së së Autoritetit Kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit. Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës, përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, gërma ç) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe VKM nr.561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, është kërkuar që operatori ekonomik të vetëdeklarojë kërkesat e mësipërme pasi AK kërkon garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike dhe do të eliminohet mundësia e abuzimit me karburantin e automjeteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për karburantin e automjeteve dhe mjeteve teknike të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme dhe duke u mbështetur në Standartet Shqiptare për karburantet të publikura nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve

më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

LOTI I DYTË; Blerje Benzinë pa plumb me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën përkatëse për tregtimin e karburanteve, sipas objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; në zbatim të Ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM nr.970, datë 02.12.2015 “Për praktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”. Me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit. Kjo certifikatë ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Është pranuar në mbarë botën se burimet e botës sonë, që po pakësohen nga dita në ditë, nuk janë të pafundme dhe se ndikimet mjedisore të produkteve dhe aktiviteteve nuk janë lokale dhe rajonale por globale. Ky ndërgjegjësim ka sjellë nevojën për të kontrolluar ndikimet mjedisore. Përveç përmbushjes së pritshmërive dhe nevojave të konsumatorëve të sotëm në nivelin më të lartë, kërkohet që të vlerësohet dhe respektohet mjedisi dhe bota në të cilën jetojmë. Këto zhvillime kanë zbuluar faktin se ekziston një nevojë për sisteme menaxheriale që do t'u mundësojnë bizneseve të mbajnë nën kontroll ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të përmirësojnë vazhdimisht aktivitetet dhe arritjet e tyre mjedisore. ISO 14001 është një standard i sistemit, i cili bazohet në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore dhe është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe ligjet në lidhje me faktorët e mjedisit. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit quhet Sistemi i menaxhimit që çdo kompani zhvillon për reduktimin sistematik dhe eliminimin e mundshëm të dëmeve që ato mund të shkaktojnë në mjedis. Pra si rezultat i këtij gjykimi menaxhimi i mjedisit që ka lidhje me certifikatën ISO 14001:2015 është standart me të cilin duhet të operojë çdo kompani pavarësisht fushës së saj të aktivitetit apo madhësisë së saj. Ky standart tregon se

kompania gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj operon në përputhje me parimet e mbrojtjes së ekosistemit dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis. Në rastin e kësaj procedure furnizimi dhe shpërndarja me karburant për ngrohje në objektet arsimore duhet patjetër të shoqërohet me garanci për mbrojtjen e mjedisit, pasi natyra dhe përdorimi i mallrave objekt prokurimi lidhet drejtpërdrejt me ndikimin në mjedis.

2.1.4 Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr.667, datë 29.07.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që *bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.*

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të

procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 20% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a), Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të

cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: *Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë-analizë për produktin Benzinë lëshuar nga ente certifikuese të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë për produktin objekt prokurimi me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara. Dëshmia me rezultatet e testeve zyrtare duhet të jetë lëshuar jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni për vërtetimin e akreditimit do të paraqitet në rastin kur OE shpallet fitues para lidhjes së kontratës ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me karburant për automjetet dhe pajisjet teknike të cilat duhet të funksionojnë sipas specifikimeve teknike të tyre, duhet të dëshmojnë që produkti ka minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në automjetet

dhe pajisjet teknike në të cilat do të përdoret pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte automjetet ose pajisjet teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të posedojë minimumi 2 (dy) stacione të tregtimit me pakicë të karburantit në Territorin e Bashkisë Tiranë. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas vendodhjes të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie dhe të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB ose kontratë noteriale qeraje). Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhen të jenë të pajisur me Vërtetim Teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), për distributorët e shitjes me pakicë, i cili duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve ATP dhe kamionë të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për mirëmbajtjen e afro 300 objekteve shkollore dhe parashkollore të Bashkisë së Tiranës të cilat janë të shpërndara në të gjithë territorin e saj, prandaj numri i stacioneve të tregtimit me pakicë të karburanteve është mëse i nevojshëm për autoritetin kontraktor dhe konsiderohet thelbësor në përmbushjen e detyrave të tij funksionale. Kjo sasi e kërkuar për posedimin e pikave me pakicë të tregtimit të karburantit është gjykuar e nevojshme dhe nga eksperiencia e autoritetit kontraktor gjatë viteve të mëparshme ku është konstatuar e nevojshme mundësia e furnizimit të automjeteve në minimalisht 3 (tre) stacione tregtimi, pasi kjo do të sillte efikasitet në kursimin e karburantit, në kushtet kur automjetet e autoritetit kontraktor e kanë vendqendrimin e tyre në 3 (tre) vendodhje të ndryshme, në rrugën Vaqarr, rrugën Shkozë dhe rrugën 5 Maji.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI (Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial), që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë së karburantit përgjatë Vitit 2024 dhe Vitit 2025.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Meqënëse kontrata e parashikuar ka një kohëzgjatje prej 12 muajsh, Autoriteti Kontraktor me anë të këtij kriteri kërkon të sigurohet për furnizimin e produktit objekt prokurimi në vazhdimësi, me cilësinë e kërkuar në DST.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- ❖ Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 (njëzet e katër) orë me karta elektronike të

personalizuara me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

- ❖ Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- ❖ Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që në rast të nevojave teknike të autoritetit kontraktor (*nevojat për furnizim të motorrëve me benzinë stacionarë si, motopompa uji, motopompa dezinfektimi, motobetoniere etj.*) të konvertojë me tollona sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar, deri në përfundim të plotë të kontratës. Kartat elektronike duhet të jenë pa afat skadence deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- ❖ Bazuar në VKM Nr.561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes se përgjithshme “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.
- ❖ Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi (shtimi dhe pakësimi) i sasisë së karburanteve, të kryhet nga vetë Autoriteti Kontraktor.
- ❖ Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë dhe shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike, stikera (pulla), të cilat ngjiten në xhanim e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet, për të eliminuar lëvizjen e mundshme të targave nga mjeti shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të emailit për çdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj.
- ❖ Disponimi/ekzistenca e faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin e shërbimeve të kërkuara më sipër, do të demonstron nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, me shembuj për zbatimin në praktikë, në prani të anëtarëve të KVO-së së Autoritetit Kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit. Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyre elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës, përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe VKM Nr.561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes se përgjithshme”. Është kërkuar që operatori ekonomik të vetëdeklarojë kërkesat e mësipërme pasi AK kërkon garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike dhe do të eliminohet mundësia e abuzimit me karburantin e automjeteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit

nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për karburantin e automjeteve dhe mjeteve teknike të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme dhe duke u mbështetur në Standartet Shqiptare për karburantet të publikura nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.